

# SUKSESI



# JEMINE

# BASHKËPUNIM DHE TOLERANCË

ARIZONA (11), ARJANIT (11), MILAZIM (11), RINESA (11), RASIMI (11), SAMIRE (12), ZELFIE (12)

Demokracia është një proces, formë e bashkëjetesës e cila nga qytetarët e saj kërkon të kenë bashkëpunim dhe tolerancë mes vete

Tema më e dashur për çdo fëmijë pa dyshim që është demokracia, kjo sepse neve qysh në këtë moshë na bën të kuptojmë rolin tonë në vendin që ne jetojmë. Por çka është demokracia do të informoheni në vazhdim të artikullit tonë. Me fjalën demokraci kuptojmë qeverisjen e një vendi nga ana e popullit d.m.th. demokracia buron nga populli dhe është në shërbim të popullit. Kjo fjalë kaq e ëmbël dhe e dashur për ne, rrjedh nga gjuha greke ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë qeverisje, e tërë kjo i bie qeverisje e popullit.


Kur themi buron nga populli mendojmë për atë që rolin kryesor në këtë sistem e luajnë qytetarët. Kemidemokracitë drejtpërdrejtësidhedemokracipër-

faqësuese. Në demokracinë drejtpërdrejtë vendimet merren nga ana e popullit, ndërsa në demokracinë përfaqësuese është populli ai që zgjedh përfaqësuesit e vet të cilët marrin vendime për tërë popullin. Vendi ynë, Kosova është vend i cili ka demokraci, por po ashtu ka edhe institucione demokratike. Si shembull më të mirë dhe që luan një rol të madh në këtë aspekt është shkolla, sepse në shkollë ne mësojmë për demokracinë, për vlerat e demokracisë si dhe sjelljet e një shoqërie demokratike. Po ashtu, shkolla neve na mëson që të gjithë jemi dhe duhet të trajtohemi në mënyrë të barabartë me njëri-tjerin. Pra, ashtu siç kam vlerë unë dhe grupi ynë, në demokraci çdo njeri e ka vlerën e vet.

Arjaniti duke i treguar shokut cilat janë shtyllat e demokracisë



Shtyllat e demokracisë



Barazia, një ndër shtyllat e demokracisë

Të gjithë në mënyrë të barabartë duke kontribuar për artikullin



Puna e grupit të demokracisë

E drejta e arsimit është e drejta themelore në vendin tonë



E drejta për arsim



# BËJE ZGJEDHJEN TËNDE

DELIVINA (11), DORUNTINA (11), ARBESA (12), VERONA (12), EDONIT (11), LAURENT (11), NILI (12)

Zgjedhja është e jotja.

Ky artikull flet për zgjedhjet e përditshme dhe ato shtetërore

Netëgjithëbëjmëzgjedhjentonë. Secilinganenëgrupin tonë, ka në mendje një profesion të cilin mendon ta ushtroj më vonë. Kjo është zgjedhje e jona që mund ta bëjmë para se të mbushim 18 vjeç. Mirëpo, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, ne duhet të jemimbi moshën 18 vjeçare. E procesi zgjedhor është procesi më i rëndësishëm demokratik. Ky proces ndodh çdo katër vjet. Ne me votën tonë zgjedhim përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues janë shumë të rëndësishëm, sepse na përfaqësojnë neve dhe e udhëheqin vendin tonë. Në Kosovë, në zgjedhjet komunale (lokale) ne i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore (parlamentare) i zgjedhim deputetët. Ne do të votojmë, sepse vota e lirë shpreh mendimin secilit. Prandaj shprehedhetimendimin tënd.




Gazetarët e artikullit gjatë punës në grup të vogël duke bashkëpunuar



Këto janë Blerta dhe Erina, njëra i përket fesë muslimane dhe tjetra fesë katolike. Megjithatë të dyja janë të barabarta



Qytetarët janë ata që zgjedhin me votën e tyre. Prandaj edhe ju me anë të votës e shprehni mendimin tuaj



Pema e zgjedhjeve



Dallimi mes zgjedhjes së përditshme dhe procesit zgjedhor



Shkolla është një ndër institucionet e vendit tonë e cila luan një rol shumë të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh



Deputetët kanë përgjegjësi të shumta



Në të ardhmen e afërt ne do të jemi zëri i popullit




Disa nga shtyllat e demokracisë janë: qeverisja e popullit, barazia para ligjit, sundimi i ligjit, bashkëpunimi



## KUVENDI DHE FUNKSIONET E TIJ

FATIME (11), ELHAME (11), MERITA (11), ARDIANA (12), ERION (11), HAJZER (11), ERMIR (11)



Ne jemi nxënës të klasës së gjashtë dhe vijmë nga fshati Rezallë, shkolla „Malush Ahmeti“. Sot ne jemi bërë gazetarë dhe kemi vendosur që të shkruajmë një artikull për Kuvendin e Kosovës

Në fillim të kësaj punëtorie ne filluam të diskutojmë për Kuvendin e Kosovës. Kuvendi është një institucion demokratik ku punojnë përfaqësuesit e qytetarëve të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë. 100 prej tyre janë deputetë shqiptarë, ndërsa 20 të tjerë janë nga komunitetet jo shumicë. 10 deputetë janë serbë dhe 10 janë turq, boshnjakë, ashkali, romë, egjiptianë dhe ghoranë. Deputetët e Kuvendit votojnë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe pastaj Kuvendi voton për Kryeministrin, Qeverinë dhe Presidentin. Ne mësuam se Kuvendi i Kosovës ka funksione të ndryshme dhe këto funksione janë: funksioni legjislativ, funksion kontrollues dhe funksioni përfaqësues. Tek funksioni legjislativ ose ligjvënës Kuvendi i vë ligjet duke i miratuar ato. Derisa deputetët i mi-

ratojnë ligjet ata bazohen në Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e reja duhet të përputhen me nenet e Kushtetutës. Kuvendi ka gjithashtu funksion përfaqësues, që do të thotë se deputetët përfaqësojnë qytetarët. Ndërsa funksioni kontrollues do të thotë se Kuvendi kontrollon Qeverinë. Deputetët duhet të përgjigjen ndaj kërkesave të qytetarëve dhe duhet të bashkëbisedojnë me ta për t'iu kuptuar problemet e tyre. Deputetët mund të kundërshtojnë njëri-tjetrin, por edhe kur deputetët kanë ndonjë problem ata mundohen ta zgjidhin atë duke diskutuar mes vete. Kjo ndodh edhe në klasën tonë. Kur ne kemi ndonjë problem në klasë, atë problem ne e zgjidhim duke biseduar me kryetarin e klasës dhe së bashku duke biseduar me njëri-tjetrin. Gjithashtu edhe vendimet në klasën tonë i marrim të gjithë së bashku, njëjtë ashtu siç i marrim vendimet e përbashkëta të gjithë deputetët e Kuvendit tonë. Prandaj ne themi se Kuvendi i Kosovës ka rol shumë të rëndësishëm për ne.



Qytetarët e rinjë të Kosovës



Kjo është Kushtetuta e Republikës sonë





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Malush Ahmeti“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Rezallë, Skenderaj